



**Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**LEGJISLATURA V**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Mbledhja nr. 66**

**Prishtinë, më 9.03.2017 në orën 9:45**

**Ndërtesa e Kuvendit, sala N-204**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Çeku, Kimete Bytyçi, Ali Berisha, Fisnik Ismaili, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

**Munguan:** Jasmina Zhivković, Mufera Shinik, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviq dhe Slavko Simiq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** përfaqësuese nga OSBE-ja, Sanije Berisha; Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

**Rend i ditës**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtur më: 13.02.2017;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Finana;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**
5. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, si komision funksional;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me raport vlerësues të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**
7. **Shqyrtimi i raportit plotësues të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ;**

8. **Caktimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për financat e Pushtetit Lokal, në bazë të planit të punës së Komisionit për vitin 2017;**
9. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

**Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e Komisionit të mbajtur më: 13.02.2017.**

**Nënkryetari**, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 13.02.2017, pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet dhe Finana;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe kërkoi nga anëtarët e komisioni të deklarohen nëse ka ndonjë propozim apo sygjërim në raport me amendamente të Komisionit Funksional.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-150 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
  - II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.
4. **Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjit Nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, si komision funksional;**

**Nënkryetari**, theksoi se nisma legislative për hartimin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit nr. 03/L 064 për festat zyrtare të Republikës së Kosovës është bërë me inisiativë të komisionit tanë, me propozim të shtohet dita meoriale për komunitetin egjiptian. Komisioni ka proceduar të gjitha argumentet e nevojshme ligjore për plotësimin e të njëjtit, në harmoni me këtë ligj. Në fazën e tanishme, Qeveria ka proceduar për shqyrtim Projektligjin nr.05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, ku ka ngarkuar Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, si komisioni funksional.

Nënkryetari dha sqarime se Ligji për festat zyrtare obligon respektimin e ditëve memoriale që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me Presidentin e Republikës së Kosovës, nga të cilat dy ditë në konsultim me komunitetin serb të Kosovës. Theksoi se në periudhën e fundit, anëtarët e komunitetit Serb nuk marrin pjesë në mbledhjet e rregullta. Në këtë kontekst, Projektligji nuk mund të procedohet pasi duhet të respektohet vota e dy të tretave të deputetëve që përfaqësojnë komunitetet joshqiptare që jetojnë në Kosovë.

Pas konsultimeve, nënkryetari konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxorri këtë:

**Përfundim**

*U muarr qëndrim që shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-139 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L 064 për festat zyrtare të tërhiqet në afat kur do të janë prezent të gjithë anëtarët e komuniteteve.*

**6. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me raport vlerësues të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti dhe Industri;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim Projektligjit Nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe theksoi se Komisionit Funksional nuk ka paraqit amendamente në këtë projektligj.

*Pas shqyrtimit të Projektligjit dhe Raportit të Komisionit Funksional, Komisioni unanimisht nxori këtë:*

**Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Nr. 05/L-127 për plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-033 për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me raportin e propozuar nga Komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

**7. Shqyrtimi i raportit plotësues të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike të Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;**

**Nënkryetari**, paraqiti për shqyrtim raportin plotësues të Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike i propozuar nga Komisioni funksional i cili nuk ka paraqit amendamente dhe me këtë rast vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sygjerime nga anëtarët e komisionit.

*Meqë nuk kishte vërejtje, nënkryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime, nxorri këtë:*

### **Rekomandim**

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentin e propozuara nga Komisioni Funkcional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

### **8. Caktimi i grupit punues për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për financat e Pushtetit Lokal, në bazë të planit të punës së Komisionit për vitin 2017;**

**Nënkryetari**, foli se për caktimin e grupeve punuese për monitorimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit për financat e Pushtetit Lokal, komisioni duhet të jetë në përbërje të plotë. Me këtë rast dha propozoim që kjo pikë të shtyhet për një periudhë të caktuar.

*Nënkryetari konstatoi se Komisioni u pajtua unanimisht dhe vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të hiqet, deri në formimin e kushteve adekuate.*

### **9. Të ndryshme.**

**Veton Berisha**, në fjalën e tij tha se Raporti me rekomandime të Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës është miratuar në seancën paraprake. Lidhur me këtë çështje ai kishte dy kërkesa, e para që rekomandimet të dërgohen në të gjitha institucionet relevante, nën dy, komisioni të këkojë zbatimin e tyre në praktikë.

**Nënkryetari**, sa i përket temës së ngritur, ai shfrytëzoi rasin të falederoi posaqërisht kryesuesit Veton Berisha, njëkohësisht edhe anëtarët tjerë të grupit punues dhe bashkëpunëtorët e administratës për mbështetje të komisionit për punë e sukseshme gjatë monitorimit të Ligjit për Shërbimin Civil. Komisioni ka dalë me Rraport me rekomandime dhe i njëjtit është miratuar në seancë plenare.

**Qerim Bajrami**, diskutoi se me iniciativën e tij ka ngritur çështjen e sigurimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve me qëllim të trajtimit në mënyrë adekuate mediat e shkruara. Komisioni ka shqyrtuar këtë problem dhe ka nxjer rekomandim që përmes Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së kryeministrit, të ndahen mjete buxhetore për mediat e shkruara në gjuhët e komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

Kërkesa e tij është që komisioni të merr iniciativë për të përcjellë zbatueshmërinë e rekomandimit për ndarjen e mjeteve buxhetore për vitin 2017

**Mbledhja përfundoi në orën 10:30.**

**E përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit.**

**Nënkryetar i Komisionit,**

---

**Agim Çeku**